



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 148

Tiranë – E premte, 21 korrik 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 19.7.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruge në trekëndëshin e hyrjes së rrugës së palmave, pranë stacionit elektrik”, Lushnjë.....	7051
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 19.7.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë.....	7052
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 490, datë 19.7.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Vlora - ACU, rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë ‘P4 C2 a, b, c’”, dhe “Ndërtim i rrugës - vazhdimi i unazës Vlorë - Uji i Ftohtë”	7053
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 491, datë 19.7.2017	Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.....	7056



VENDIM
Nr. 488, datë 19.7.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIM RRUGE NË
TREKËNDËSHIN E HYRJES SË RRUGËS
SË PALMAVE, PRANË STACIONIT
ELEKTRIK”, LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruge në trekëndëshin e hyrjes së rrugës së palmave, pranë stacionit elektrik”, Lushnjë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 295 234 (katër milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 295 234 (katër milionë e dyqind e nëntëdhjetë e

pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Vlera e shpronësimit e truallit të z. Lula Ali Duma+bashkëpronarë
Në lagjen “Loni Dhamo”, zona kadastrale 8572

INVESTITORI: BASHKIA LUSHNJË

Nr.	N/ pasurisë	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	1/526	Lula Ali Duma + bashkëpronarë	8572	Truall	m ²	479.7	8954	4295234	Shkresa nr. 1623/2, datë 21.3.2017
Shuma totale								4295234	



VENDIM
Nr. 489, datë 19.7.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, OST sh.a-së.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompesimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për

sipërfaqen 1 798.89 m² tokë arë, me shumën e përgjithshme 366 974 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit korrik 2017.

6. Çdo pronar, për t’u likuiduar për efekt shpronësimi, të dorëzojë pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësi mit për nënstacionin m ²	Vlera e shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m ²				
Bashkia Vlorë											
Tragjas											
1	Merushë		Harizaj	3621	998/23	Arë	2046	1723.2	204	351533.0	
2	Krenar		Harizaj	3621	998/24	Arë	2046	75.69	204	15441.0	Bashkëpronësi
Sipërfaqe totale për shpronësim në m²								1798.89			
Shuma totale në lekë për shpronësim										366974	

**VENDIM**

Nr. 490, datë 19.7.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “VLORA - ACU, RIKUALIFIKIM URBAN NË QYTETIN E VLORËS, PËRGJATË ‘P4 C2 A, B, C’”, DHE “NDËRTIM I RRUGËS - VAZHDIMI I UNAZËS VLORË - UJI I FTOHTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Vlora - ACU, Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë ‘P4 C2 a, b, c’”, dhe “Ndërtim i rrugës - vazhdimi i unazës Vlorë - Uji i Ftohtë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 146 011 365 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 146 011 365 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e njëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TABELA ME LISTËN E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE VLERAT E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT: SHTOJCA 2/1
VLORA ACU, RIKUALIFIKIM URBAN NË QYTETIN E VLORËS PËRGJATË SHËTITORES P4-C2-A, B, C DHE NDËRTIM I RRUGËS VAZHDIM I UNAZËS VLORË - UJI I FTOHTË

NR.	Z. K.	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe truallit	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtësës	Shënime
Ndërtim i rrugës vazhdim i unazës Vlorë - Uji i Ftohtë												
1	8602	40/75	Vlorë	BP Sadiku	33	10903	359,799				359,799	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
2	8602	40/98/1	Vlorë	Evloqia Kissi	15.5	204	3,162				3,162	Saktësim dokumentacioni
3	8602	40/98/2	Vlorë	Evloqia Kissi	198	204	40,392				40,392	Saktësim dokumentacioni
4	8602	40/130	Vlorë	Lefter Cenaj	25	10903	272,575				272,575	Saktësim dokumentacioni
5	8602	40/290	Vlorë	Mbivendosje	8.5	10903	92,676				92,676	Saktësim dokumentacioni
6	8602	40/289	Vlorë	BP Sadiku	47	10903	512,441				512,441	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Pasuria është e llojit truall.
7	8602	40/271	Vlorë	Martin Balili	158	10903	1,722,674				1,722,674	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Pasuria është e llojit truall.
8	8602	40/132	Vlorë	BP Koleka	494.1	10903	5,387,172				5,387,172	Saktësim dokumentacioni
9	8602	40/265	Vlorë	Mbivendosje	186.5	10903	2,033,410				2,033,410	Saktësim dokumentacioni
10	8602	41/5	Vlorë	BP Koleka, Harito etj	915.2	10903	9,978,426				9,978,426	Saktësim dokumentacioni
11	8602	77/5	Vlorë	Trashëgimtaret e Jahja Mici, Alije Selmanaj, Bashkim Duka, Hiqmet Mici, Kenaqesi Gjuni, Rahim Mici dhe Violeta Mici	620	10903	6,759,860				6,759,860	Saktësim dokumentacioni
12	8602	41/305	Vlorë	Mbivendosje	181.5	204	37,026				37,026	Saktësim dokumentacioni
13	8602	41/390	Vlorë	B.P Velaj, Haxhiu	22.6	10903	246,408				246,408	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
shuma totale 1											27,446,020	
Vlora ACU, Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës përgjatë shëtitores P4-C2-a, b, c												
14	8602	27/265	Vlorë	Vasilika Hanxhari	175	10903	1,908,025				1,908,025	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Sekuestro konservative
15	8602	27/266	Vlorë	Vasilika Hanxhari	175	10903	1,908,025				1,908,025	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Sekuestro konservative
16	8602	27/267	Vlorë	Mojsi Lazaj	175	10903	1,908,025				1,908,025	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
17	8602	27/559	Vlorë	Arsen Sacaj	300	10903	3,270,900				3,270,900	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
18	8602	27/560	Vlorë	Vasilika Hanxhari	300	10903	3,270,900				3,270,900	Saktësim dokumentacioni
19	8602	27/458/2	Vlorë	Premti Bitri, Niko Bitri, Zhuljana Bitri, Xhorxhi Bitri, Evloqia Kissi, Gjinovefa Ndrino, Lllazar Bitri, Arqile Bitri	20	10903	218,060				218,060	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
20	8602	27/458/1	Vlorë	Lllazar Bitri, Mojsi Lazaj	276.3	10903	3,012,499				3,012,499	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
21	8602	27/80	Vlorë	Qani Ferataj, Habibe Ferataj, Salihe Ferataj, Myzejen Ferataj, Enver Ferataj, Virjon Ferataj, Mysadete Ferataj, Gjeraqin Ferataj, Bujar Ferataj, Ermal Ferataj, Sinan Ferataj.	73	10903	795,919				795,919	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
22	8602	27/459	Vlorë	Vasilika Hanxhari	34.7	10903	378,334				378,334	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. RVP
23	8602	27/542	Vlorë	Nezmi Mezani, Mehmet Mezani, Farie Selimi, Haxhire Mezani, Haxh Mezani	41.5	10903	452,475				452,475	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë



24	8602	27/47	Vlorë	Ninfa Ziu, Pranvera Ballhysa, Fatos Muço, Judit Shahu, Bahir Resuli	587.3	10903	6,403,332				6,403,332	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
25	8602	27/48	Vlorë	Bp Risilia	121.94	10903	1,329,512				1,329,512	Saktësim dokumentacioni
26	8602		Vlorë	Sherif Llanaj	58.86	10903	641,751	58.86	51,011.54	3,002,539	3,644,290	Saktësim dokumentacioni. Në proces regjistrimi. Ndodhet brenda godinës me nr. pasurie 27/48
27	8602	27/55-ND	Vlorë	Vllasi Dardha				36.75	51,011.54	1,874,674	1,874,674	Saktësim dokumentacioni
28	8602	27/574	Vlorë	Vllasi Dardha	244	10903	2,660,332				2,660,332	Saktësim dokumentacioni
29	8602	27/560	Vlorë	Zeqire Xhaferi, Zamir Xhaferi, Avni Xhaferi, Arben Xhaferi	182	10903	1,984,346	44	51,011.54	2,244,508	4,228,854	Saktësim dokumentacioni
30	8602	27/421	Vlorë	Margarita Baba				59.3	51,011.54	3,024,984	3,024,984	Saktësim dokumentacioni
31	8602	27/415	Vlorë	BP Mone, Llavdaniti, Gjika	31.8	10903	346,715				346,715	Saktësim dokumentacioni
32	8602	27/377	Vlorë	Klodjan Kapllanaj, Leka Kapllanaj	39.25	10903	427,943				427,943	Saktësim dokumentacioni
33	8602	27/91-ND	Vlorë	PPV				38.20	51,011.54	1,948,641	1,948,641	Saktësim dokumentacioni
34	8602	27/378	Vlorë	PPV	172.5	10903	1,880,768				1,880,768	Saktësim dokumentacioni
35	8602	27/534	Vlorë	Halil Cobo	267.8	10903	2,919,823				2,919,823	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
36	8602	27/545	Vlorë	Nazmi Barjami	144.6	10903	1,576,574	196.00	51,011.54	9,998,262	11,574,836	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
37	8602	27/89-ND	Vlorë	Edlira Tola				83.50	51,011.54	4,259,464	4,259,464	Saktësim dokumentacioni
38	8602	27/349	Vlorë	Ardjan Fejzo Bajramaj	200	10903	2,180,600	358.00	51,011.54	18,262,131	20,442,731	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë
39	8602	27/350/1	Vlorë	Edlira Tola	110	10903	1,199,330				1,199,330	Saktësim dokumentacioni
40	8602	35/143	Vlorë	BP. Shehu, Meçaj etj	2685	10903	29,274,555				29,274,555	Saktësim dokumentacioni
41	8602	23/161	Vlorë	Ferdinand Bezhani, Leonidha Bezhani, Vasiliqi Gjini	367	10903	4,001,401				4,001,401	Saktësim dokumentacioni

Shuma totale 2

118,565,346

Shuma totale 1+2**146,011,365**

Çmimi i truallit sipas VKM-së 89, datë 3.2.2016

Çmimi për objektet sipas VKM-së 138, datë 23.3.2000 dhe udhëzim nr. 3, datë 28.12.2016. i EKB-së Tiranë

**VENDIM**

Nr. 491, datë 19.7.2017

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KUSHTEVE TEKNIKE DHE NORMAVE TË MIRËMBAJTJES SË INSTALIMEVE NËN PRESION, QË SHËRBEJNË PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN, DEPOZITIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 8, 9, 10, 16, 17 e 22, të ligjit nr. 32/2016, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, dhe të neneve 11, 12, 13, 14, 15, 16, 22 e 23, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
QËLLIMI**

1. Qëllimi i këtij vendimi është rritja e sigurisë dhe përmbushja e standardeve gjatë kryerjes së aktiviteteve në përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, nëpërmjet kryerjes së shërbimeve periodike, të specializuara, për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe të instalimeve nën presion që u shërbejnë këtyre aktiviteteve, si dhe certifikimit të zbatimit të normave teknike në këtë fushë.

**KREU II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRIVE QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E PËRPUNIMIT, TË TRANSPORTIMIT, DEPOZITIMIT DHE TREGTIMIT TË NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

1. Ushtrimi i aktivitetit të përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimin të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, duhet të kryhet duke përdorur pajisje dhe instalime që

plotësojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në rregullat e rregulloret teknike përkatëse në fuqi, dhe duke kryer mirëmbajtjen e pastrimit periodik vjetor të tyre, nëpërmjet proceseve të posaçme, në përputhje me përcaktimet e neneve 6, 8, 9 e 10, të ligjit nr. 32/2016.

2. Shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e përpunimit, të transportimit, depozitimit dhe tregtimin të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre janë përgjegjëse për kryerjen e kontrollit teknik, periodik të instalimeve të tyre, të cilat duhet të jenë të pajisura edhe me mbrojtjen katodike dhe duhet të demonstrojnë përputhshmërinë e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi për konformitetin.

3. Shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e përpunimit, të transportimit, depozitimit dhe tregtimin të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, përveç raportimit që bëjnë për numrin dhe volumet e pajisjeve e sistemeve të tyre teknologjike që disponojnë, në funksion të veprimtarisë së tyre, raportojnë edhe planin e mirëmbajtjes e të pastrimit vjetor, sipas kërkesave të pikës 1, të këtij kreu.

**KREU III
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRIVE QË KRYEJNË SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES E TË PASTRIMIT**

1. Shërbimet e mirëmbajtjes e të pastrimit të sistemeve të përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre kryhen nga subjekte të themeluara sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi. Këto subjekte duhet të disponojnë pajisje të teknologjisë bashkëkohore dhe staf të kualifikuar për kryerjen e kësaj veprimtarie, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32/2016, si dhe të vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”.

2. Në përfundim të kryerjes së proceseve të punës, sipas planit të mirëmbajtjes, të përcaktuar në pikën 3, të kreut 2, të këtij vendimi, shoqëria që kryen shërbimin përgatit një dokument, nëpërmjet të cilit vërtetohet kryerja e shërbimeve të mirëmbajtjes.



3. Kushtet që duhet të plotësojnë shoqëritë që sigurojnë shërbimet e mirëmbajtjes, si dhe formati e procedura e lëshimit të dokumentit vërtetues të kryerjes së shërbimit, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës që mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

KREU IV DETYRAT E INSPEKTORATIT SHTETËROR PËRGJEGJËS

Inspektorati shtetëror përgjegjës, në varësi të ministrisë përgjegjëse që mbulon veprimtarinë hidrokarbure, në përputhje me përcaktimet e nenit 23, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të neneve 16 e 17, të ligjit nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, merr masa për zbatimin e këtij vendimi. Në rastet kur konstatohet mosrespektimi i kërkesave të këtij vendimi, inspektorati shtetëror përgjegjës merr masat përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

KREU V KONTROLI PËR RESPEKTIMIN E KUSHTEVE TEKNIKE

1. Vërtetimet teknike për respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike për depozitimin, transportimin dhe

tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre lëshohen nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit, të akredituara në fushën e certifikimit dhe të inspektimit teknik të linjave teknologjike në fushën hidrokarbure. Këto organe, përveç kërkesave të përgjithshme të akreditimit, duhet të plotësojnë edhe kërkesa të veçanta për njohjen dhe operimin e sistemeve e të instalimeve të fushës hidrokarbure.

2. Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë këto organe, kushtet dhe procedura për lëshimin e vërtetimeve teknike miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës që mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

KREU VI TË NDRYSHME

1. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë aktet nënligjore në zbatim të krerëve 3 e 5 të këtij vendimi.

2. Të gjitha dispozitat e përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, shfuqizohen, nëse bien ndesh me dispozitat e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 84 lekë